



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 3129 / Prot.  
12

Tiranë, më 22. 6. 2021

**URDHËR**

Nr. 173, datë 22. 6. 2021

**PËR**

**PROCESIN ZGJEDHOR PËR AUTORITETET DREJTUESE NË  
AKADEMINË E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 129 dhe 131 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

**URDHËROJ:**

1. Fillimin e procesit zgjedhor për autoritetet drejtuese në Akademinë e Studimeve Albanologjike, në datën 22.6.2021.
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet drejtuese në Akademinë e Studimeve Albanologjike, të jetë data 21.7.2021.
3. Akademia e Studimeve Albanologjike të marrë masat që të miratojë rregulloren e zgjedhjeve, të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara datës së fillimit të procesit zgjedhor, e cila duhet të depozitohet pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
4. Kandidatët për autoritete drejtuese në Akademinë e Studimeve Albanologjike, me qëllim garantimin e integritetit të lartë, përpara aplikimit duhet të kenë marrë vlerësim pozitiv nga Këshilli i Etikës, i cili verifikon ligshmërinë e fitimit të gradës shkencore dhe titullit akademik, përfshirë kontrollin antiplagjiaturë. Kriteri i vlerësimit të kandidatëve nga Këshilli i Etikës dhe procedurat, të përcaktohen në rregulloren përkatëse të zgjedhjeve të IAL-së.
5. Menjëherë pas zhvillimit të procesit zgjedhor dhe konstituimit të organeve dhe autoriteteve drejtuese, Akademia e Studimeve Albanologjike të vijojë procesin e riorganizimit si institucion i arsimit të lartë në zbatim të nenit 129 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë" dhe të hartojë

planin e veprimit për riorganizim në llojin e institucionit të arsimit të lartë "Akademi", sipas vendimmarrjes së organeve të saj të brendshme. Akademia e Studimeve Albanologjike të ndjekë me prioritet vijimin e punës për riorganizimin e saj, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, si për sa i përket njësive kryesore dhe njësive bazë, pjesë përbërëse të saj, ashtu edhe programeve të studimit që do të ofrojë kjo Akademi.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Akademia e Studimeve Albanologjike.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**EVIS KUSHI**

